



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna e Klinës

Nr. 06-17597/25

Datë: 11.06.2025

NJOFTIM PËR DËGJIM BUXHETOR

Bazuar në LIGJI NR. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Financat Publike dhe Përgjegjësit, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Kuvendi Komunal Klinë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, hapin procesin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB 2026-2028. Korniza afatmesme Buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2026-2028 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioritetëve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentet strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës. KAB 2026-2028 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2026. Konsultimi publik është i hapur nga **data 28 maj 2025, deri më 24 qershor 2025.**

Ftohen të gjitha institucionet komunale, Qytetarët, OJQ-të, Bizneset, Bashkësitë Lokale, Mediat dhe grupet tjera të interesit që të marrin pjesë në Dëgjimin Buxhetor për KAB 2026 – 2028, më këtë;

RENDI I DITËS

SHQYRTIMI I KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE 2026-2028.

Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim më temë “Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës, datë 20.06.2025, ora 14:00.

Materiali në formë fizike mund të merret në Zyrën për Punë të Kuvendit, Zyrën e Kryetarit si dhe Zyrën e Drejtorisë së Financave, po ashtu, gjendet edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe Platformën e Konsultimeve Publike:

Komuna Klinë:

<https://kline.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Platforma e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Propozimet e juaja lidhur me këto akte mund t'i dorëzoni me shkrim në Zyrën e Kuvendit, kati I, zyra e dytë, korridori në anën e djathtë si dhe Zyra e Kryetarit, kati II, zyra parë.

Gjithashtu, në mënyrë elektronike tek zyrtarët:

1. Vlora Tafili, email: vlora.tafili@rks-gov.net
2. Melihate Behramaj, email: melihate.behramaj@rks-gov.net;

Mirëpresim propozimet dhe sugjerimet e juaja nga data **28.05.2025**, gjatë mbajtjes së dëgjimit dhe deri me datën **24.06.2025** nëpërmes mjeteve elektronike.

Pas përfundimit të fazës së diskutimit publik, propozimet e juaja do të merren në konsideratë duke u shqyrtuar në raportin e konsultimit publik si dhe në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës konform dispozitave ligjore.

Kryetari i Komunës,
Zenun Elezaj



Kryesuesi i Kuvendit Komunal,
Fadil Gashi

